

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7012
E mërkurë, 4 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Serbia arreston Millan Radoiqiqin, i caktohet masa e paraburgimit për 48 orë FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PAS NGJARJEVE NË VERI OPOZITA KA KËRKUAR NGA KURTI TA RRISE BASHKËPUNIMIN ME ALEATËT STRATEGJIKË, VEÇANËRISHT SHBA-në FAQE 4-5

AKTUALE



OPOZITA I KËRKON KURTIT BASHKËPUNIM ME ALEATËT STRATEGJIKË, SIDOMOS ME SHBA-në

KURTI U KËRKON KOMUNITETEVE TË MARRIN PJESË NË REGJISTRIMIN E POPULLSISË F. 7

SBASHK-U ANKOHET TEK UNIONI I SINDIKATAVE TË ARSIMIT TË EVROPËS PËR QEVERINË KURTI F. 7

NIS PUNËN SHËRBIMI STOMATOLOGJIK NË QMF-NË E FSHATIT TËRSTENIK TË DRENASIT F. 6

KDI-ja: VETËM 17 PËR QIND E QYTETARËVE DINË SE MUND TË PËRFSHIHEN NË REFORMËN E DREJTËSISË F. 7



EKONOMI



Pushteti dhe opozita kanë reaguar edhe të martën për ngjarjet e fundit në Banjskë të Zveçanit. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se Serbia nuk është e interesuar për bashkëpunim


rajonat për anëtarësim në BE, por më shumë për orientime alternative gjeopolitike që i mundësojnë asaj t'i mirëmbajë ambicjet hegjemonike ndaj shteteve përreth. Ndërkaq

opozita ka kërkuar nga qeveria Kurti ta rrisë bashkëpunimin me aleatët strategjikë si dhe ka kërkuar hetim ndërkombëtar për t'i zbardhur skenarët e fundit në veri

TELEKOMI PROBLEME ME PAJISJE, NDËRPRITEN THIRRJET, KONSUMATORËT ANKOHEN F. 8

PDK-ja DHE LDK-ja KRITIKOJNË MINISTRIN MURATI, SHKAK INFLACIONI DHE TË HYRAT F. 8

SPORT



STADIUMI 'FADIL VOKRRI' MUND TË MOS RINOVHET FARE F. 10

SINDIKATA E POLICISË DORËZON NË KUVEND PETICIONIN ME 10 KËRKESA



Sindikata e Policisë e Kosovës ka dorëzuar të martën në Komisionin për të Drejtat e Njeriut një peticion me 5 623 nënshkrime të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Peticioni përmban dhjetë kërkesa që duhet të aprovohen nga institucionet e shtetit: Ligji i Pagave, shtesa e rrezikshmërisë në punë, shtesa për

punë të veçantë, klasifikimi në koeficient për stafin civil, shujta mujore, shpërblimi për fundvit për performancë të mirë, tri paga përcjellëse për të pensionuarit, zbritja e përvojës së punës, sigurimi shëndetësor dhe jetësor, si dhe Ligji për Pensionim në Policinë e Kosovës

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Nis gjykimi ndaj Donald Trumpit nën akuzat për mashtrim financiar

UASHINGTON, 3 TETOR - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, doli para një gjykate në Nju-Jork të hënën, për t'u përballur me akuzat për mashtrim financiar. Trump e quajti të "rrejshëm" rastin gjyqësor ndaj tij, duke thënë se synimi i këtij rasti është parandalimi i kthimit të tij në Shtëpinë e Bardhë. Gjyqi për mashtrim, njëri nga disa betejat ligjore kundër 77-vjeçarit, mund të ndikojë që ish-presidentit t'i ndalohet bërja biznes në shtetin e Nju-Jorkut. "Kjo ka të bëjë me ndërhyrje në zgjedhje, kaq e thjeshtë është", tha Trumpi teksa mbërriti në gjykatë për seancën hapëse në një gjyq që mund të zgjasë tre muaj. "Ajo çfarë po ndodh këtu është përpjekje për të më dëmtuar mua në zgjedhje", shtoi ai. Gjykatësi i Nju-Jorkut, Arthur Engoron, i ka shpallur tashmë

Trumpin dhe djemtë e tij, Eric dhe Don Jr, fajtorë për mashtrim duke i fryrë vlerat e patundshmërisë dhe asetëve financiare të Organizatës Trump për vite të tëra. Prokurorja e Nju-Jorkut, Letitia James, po kërkon ndëshkime në vlerë 250 milionë për Trumpin dhe përjashtimin e tij dhe të djemve të tij nga udhëheqja e perandorisë familjare të biznesit. "Drejtësia do të triumfojë", tha James para gazetarëve. "Nuk ka rëndësi sa i fuqishëm je, nuk ka rëndësi sa shumë para mendoni se mund të kenë, askush nuk është mbi ligjin", tha ajo. Duke mbërritur në gjykatë, Trumpi e cilësoi rastin ndaj tij të "rrejshëm" dhe "gjueti shtrigash". "Ky është i rrejshëm. Deklaratat e mia financiare janë fenomenale", nguli këmbë Trumpi. Trumpi do të dalë para gjykatës federale në Uashington më 4



mars 2024, nën akuzat se kishte tentuar ta përmbyste rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020, të cilat i fitoi demokrati Joe Biden. Ai do të kthehet pastaj në gjykatën e Nju-Jorkut, këtë herë

për t'u përballur me akuzat se e kishte paguar një yll të pornografisë për të heshtur, më pas në Gjykatën Federale të Floridës, ku akuzohet se i kishte keqpërdorur dokumentet e klasifikuara pasi ishte larguar

nga Shtëpia e Bardhë. Dhe në fund, Trumpi do të përballlet me akuza për përpjekjet e tij për ta kthyer në favorin e vet rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2020 në shtetin e Xhorxhias.

Turqia arreston dhjetëra persona pas sulmit në Ankara



ANKARA, 3 TETOR - Policia i ka ndaluar të paktën 67 persona të martën në Turqi teksa e kryen një aksion për t'i shënjestruar personat e lidhur me militantët kurdë. Aksioni është duke u kryer disa ditë pas një sulmi vetëvrasës në Ankara. Ministri i Brendshëm turk Ali Yerlikaya ka thënë se policia ka kryer bastisje në 16 provinca turke, duke i arrestuar 55 persona që dyshohet se kanë qenë pjesë e një "strukture të inteligjencës" të Partisë Popullore të Kurdistanit (PKK). Të paktën 12 të dyshuar të tjerë si pjesëtarë të PKK-së janë arrestuar në një operacion të ndarë në pesë provinca, ka thënë Yerlikaya në X

- platformë e njohur më parë si "Twitter". PKK-ja ka kryer kryengritje disadekadëshe në Turqi dhe konsiderohet organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. Dhjetëra mijëra persona kanë vdekur prej nisjes së konfliktit më 1984. Të dielën një person e ka kryer një sulm vetëvrasës afër hyrjes së Ministrisë së Punëve të Brendshme në Ankara, disa orë para se presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan të mbante një fjalim në parlament. Sulmuesi i dytë është vrarë nga forcat policore. PKK-ja ka pretenduar se është përgjegjëse për sulmin.

Tre shkencëtarë fitojnë Nobelin për Fizikë për përdorim të dritës në studim të elektroneve

STOKHOLM, 3 TETOR - Çmimi Nobel për Fizikë u është ndarë tre shkencëtarëve që kanë kryer eksperimente me dritën dhe të cilat e kanë hapur derën e botës së elektroneve. Çmimin këtë vit do ta ndajnë Pierre Agostini, Ferenc Krausz and Anne L'Huillier. Puna e tyre ka demonstruar një mënyrë për krijimin e pulseve jashtëzakonisht të shkurtra të dritës, të cilat mund të përdoren për t'i studiuar proceset e shpejta brenda atomeve.

Fituesit do ta ndajnë shumën prej 994 000 eurosh. Akademia Suedeze e Shkencave ka thënë se eksperimentet e tre laureatëve kanë prodhuar "pulse të dritës aq të shkurtra sa që ato janë matur me atosekonda". Një atosekondë është kuintilontë e sekondës. Kjo shpejtësi është e barasvlershme me kohëzgjatjen e një sekonde përballë viteve të Universit. Sipas Akademisë, kjo punë ka demonstruar se këto pulse jashtëzakonisht të shkurtra mund

të përdoren më pas për të kuptuar sesi funksionojnë elektronet. Elektronet janë pjesë brenda atomit dhe lëvizin jashtëzakonisht shpejt - në miliarda të sekondës. "Fizika e atosekondës" është duke çuar përpara procese të rëndësishme lidhur me funksionimin e atomeve dhe molekulave. Ky zhvillim pritet të rezultojë në testime më të mëdha, që potencialisht mund të ndikojë në diagnostikim të sëmundjeve në fazë shumë më të hershme.



Sindikata e Policisë dorëzon në Kuvend petitionin me 10 kërkesa

Sindikata e Policisë së Kosovës ka dorëzuar të martën në Komisionin për të Drejtat e Njeriut një petition me 5623 nënshkrime të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës. Peticioni përmban dhjetë kërkesa që duhet të aprovohen nga institucionet e shtetit: Ligji i Pagave, shtesa e rrezikshmërisë në punë, shtesa për punë të veçantë, klasifikimi në koeficient për stafin civil, shujta mujore, shpërblimi për fundvit për performancë të mirë, tri paga përcjellëse për të pensionuarit, zbritja e përvojës së punës, sigurimi shëndetësor dhe jetësor, si dhe Ligji për Pensionim në Policinë e Kosovës

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 36 TETOR - Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione ka pranuar një petition me dhjetë kërkesa nga Sindikata e

Policisë e Kosovës. Lajmin e ka dhënë anëtarja e këtij komisioni, njëherësh deputete e Partisë Demokratike të Kosovës, Ariana Musliu-Shoshi, e cila ka thënë se Policia e Kosovës meriton përkrahje me vepra, "boll me fjalë". "Në Komisionin Parlamentar për të Drejta të Njeriut kemi pranuar



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT POLICIE KOSOVA
KOSOVO POLICE UNION

Numri/No: 04/10/23, Nr. Anëtar/No. pp: 2
Data/Date: 18.07.2023
PRISHTINË PRISTINA, PRISHTINË

SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT KOSOVSKE POLICIE
KOSOVO POLICE UNION

REFERENCË:	SPK-01/010/2023	DATA: 18.07.2023
PËRZATO:	Kuvendit të Republikës së Kosovës - Z. GLAUK KONJUFCA Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione	
CC:	Drejtpërdrejtë	
PËRMES/PREKO/THRU:	Drejtpërdrejtë	
NGA/OD/FROM:	Sindikata e Policisë së Kosovës	
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Peticion	

Të ndëruar anëtarë të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Duke pasur parasysh kushtet dhe ambientin e punës, Policia e Kosovës është ndër institucionet me rrezikshmërinë më të lartë në shoqëri si nga aspekti i shëndetit ashtu edhe nga aspekti i rrezikut për jetë. Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore përballet me rreziqe të drejtpërdrejta për jetën dhe shëndetin si dhe situata stresuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë policore. Zyrarët policor kanë autorizim të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të rrezikshme gjithashtu për jetën dhe shëndetin, i ekspozohen rrezikut në mënyrë permanente dhe të befasishme. Situata të tilla paraqiten në baza ditore rastet si: gjatë përgjigjes në thirrjet e qytetarëve për ndihmë dhe ofrim të shërbimeve; kontrolli dhe sigurimi i kufirit shtetëror; intervenimi dhe reagimi në rastet e krimeve dhe incidenteve të ndryshme; fatkeqësi natyrore; aksidentet në trafik; ballafaqimi me trazira dhe prishje të rendit dhe sigurisë publike në përmasa të mëdha; arrestimi dhe transportin e personave me rrezikshmëri; zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit; luftimi i krimit përfshirë por pa u kufizuar vetëm në krimin e organizuar, terrorizmin, narkotikë, kontrabandën me armë dhe mallra, trafikimin me qenie njerëzore; kërkimi dhe arrestimi i personave të arratisur; gjurmimi dhe zbulimi i materieve helmuese dhe eksplozive por edhe trajtimi i materieve të tilla; shpëtimi i pengjeve; rastet e kidnapimit; goditja e grupeve kriminale të organizuara; kërcënimeve me armë dhe materie tjera eksplozive; bazuar në dispozitat ligjore zyrtari policorë, në të gjitha rrethanat, kur e takon një incident në progres ka obligim ligjor 24/7 orë të ndërhyjë dhe t'a menaxhojë incidentin pavarësisht nivelit të rrezikut për jetën e tij, etj.

Për të ilustruar më detajisht specifikat e dhe rrezikshmërinë në punë, flasin të dhëna tona se deri me tani në kryerje të detyrës kanë humbur jetën 23 zyrarë policor, kanë vdekur në detyrë 322 zyrarë, 4753 rate të lëndimeve të zyrarëve policor në kryerjen e detyrave zyrtare, 319 zyrarë të sëmurë në detyrë, aktualisht me sëmundje të veçanta shëndetësore janë 528 zyrarë. Deri tani kemi 2285 pjesëtarë të policisë të cilët kanë dhënë dorëheqje vullnetare nga Policia.

petition nga Sindikata e Policisë së Kosovës me 5623 nënshkrime nga pjesëtarë të Policisë të Kosovës. Kërkesat e tyre janë të domosdoshme dhe duhet të aprovohen pa asnjë vonesë", ka shkruar ajo në "Facebook". Musliu-Shoshi ka treguar se kërkesat e sindikatës janë: Ligji i Pagave, shtesa e rrezikshmërisë në punë, shtesa për punë të veçantë, klasifikimi në koeficient për stafin civil, shujta mujore, shpërblimi për fundvit për performancë të mirë, tri paga përcjellëse për të pensionuarit, zbritja e përvojës së punës nga 0.5 në 0.25 për 15 vitet e para, sigurimi shëndetësor dhe jetësor si dhe Ligji për Pensionim në Policinë e Kosovës. Pushteti me votë në Kuvend duhet ta dëshmojë përkrahjen", ka Musliu-Shoshi. Sindikata e Policisë së peticionin e dorëzuar ka theksuar se duke pasur parasysh kushtet dhe ambientin e punës, Policia e Kosovës është ndër institucionet me rrezikshmërinë më të lartë në shoqëri si nga aspekti i shëndetit, po ashtu edhe nga aspekti i rrezikut për jetë. "Policia e Kosovës gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve policore përballet me rreziqe të

drejtpërdrejta për jetën dhe shëndetin si dhe situata stresuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë policore. Zyrarët policorë kanë autorizim të përdorimit të mjeteve dhe pajisjeve të rrezikshme për jetën dhe shëndetin, i ekspozohen rrezikut në mënyrë permanente dhe të befasishme. Situata të tilla paraqiten në baza ditore; gjatë përgjigjes në thirrjet e qytetarëve për ndihmë dhe ofrim të shërbimeve, kontrolli dhe sigurimi i kufirit shtetëror; intervenimi dhe reagimi në rastet e krimeve dhe incidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, aksidentet në trafik, ballafaqimi me trazira dhe prishje të rendit dhe sigurisë publike në përmasa të mëdha, arrestimi dhe transporti i personave me rrezikshmëri, zbatimin e masave të fshehta të hetimit dhe vëzhgimit, luftimi i krimit etj", është thënë në peticionin e Sindikatës së Policisë. Kjo sindikatë ka njoftuar se deri më tani në kryerje të detyrës kanë humbur jetën 23 zyrarë policorë, kanë vdekur në detyrë 322 zyrarë, 4 753 raste të lëndimeve të zyrarëve policorë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe 319 zyrarë të

sëmurë në detyrë. Aktualisht me sëmundje të veçanta shëndetësore janë 528 zyrarë. Sipas kësaj shkresë të Sindikatës së Policisë, deri më tani 2 285 pjesëtarë të policisë kanë dhënë dorëheqje vullnetare. "Duke u bazuar në pakënaqësitë e të punësuarve në Policinë e Kosovës, të shprehur edhe përmes nënshkrimit të peticionit, Sindikata e Policisë së Kosovës kërkon nga Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione që ta ngrehin këtë çështje me qëllim të përkrahjes, përmirësimit të kushteve dhe mirëqenies të të punësuarve në Policinë e Kosovës. Po ashtu, kërkohet nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Kosovës, nga presidentja, kryeparlamentari, kryeministri, ministri i MPB-së, që të aprovohen kërkesat tona, të cilat janë jetike për përmirësimin e mirëqenies së të punësuarve në Policinë e Kosovës dhe familjeve të tyre", është thënë në peticionin e dorëzuar nga Sindikata e Policisë së Kosovës.


Universiteti i Prishtinës mirëpret bashkëpunimin me Universitetin Keios

PRISHTINË, 3 TETOR - Universiteti i Prishtinës ka mirëpritur profesorin Masahito Kawamori. "Takimi është vazhdimësi e bashkëpunimit me Universitetin Keio, duke qenë se ky universitet, si më i vjetri në Japoni, dhe Universiteti i Prishtinës kanë zyrtarizuar procesverbalin e takimit që i paraprin memorandumit të

bashkëpunimit. Qëllimi kryesor i këtij takimi janë mundësitë për bashkëpunim, integrimi i TIK dhe IA, teknologjitë më të avancuara dhe bashkëpunimi specifik i fakulteteve", ka njoftuar UP-ja. Rektori i UP-së, Qerim Qerimi, ka vlerësuar praninë e profesorit në universitet dhe ka përmendur mundësitë e

bollshme për bashkëpunim me Universitetin Keio në fusha të ndryshme, pasi ka një mori fushash të përgatitura për partneritet. "Universiteti i Prishtinës mirëpret bashkëpunimin me Universitetin Keio në fusha të ndryshme që kanë rëndësi për institucionin, studentët tanë dhe komunitetin më të gjerë", ka njoftuar UP-ja.





Ngjarjet në veri, opozita kërkon nga Kurti ta rrisë bashkëpunimin me aleatët strategjikë, sidomos ShBA-në

Pushteti dhe opozita kanë reaguar edhe të martën për ngjarjet e fundit në Banjskë të Zveçanit. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se Serbia nuk është e interesuar për bashkëpunim rajonal për anëtarësim në BE, por më shumë për orientime alternative gjeopolitike që i mundësojnë asaj t'i mirëmbajë ambicet hegjemonike ndaj shteteve përreth. Ndërkaq opozita ka kërkuar nga qeveria Kurti ta rrisë bashkëpunimin me aleatët strategjikë si dhe ka kërkuar hetim ndërkombëtar për t'i zbardhur skenarët e fundit në veri

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 TETOR - Pushteti dhe opozita kanë reaguar edhe të martën për ngjarjet e fundit në Banjskë të Zveçanit, ku si pasojë e sulmeve është vrarë rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku dhe gjatë përlëshjeve me policinë janë vrarë edhe tre sulmues. Përgjegjësini për sulmet në Banjskë e ka marrë Millan Radojiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe. Kryeministri Albin Kurti ka thënë

se është e rëndësishme që pas sulmit terrorist të Serbisë kundër Kosovës, të mos sillemi sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Ai ka thënë se duhet të ketë pasoja për sjelljen e Serbisë dhe të gjithë autorët duhet të mbahen përgjegjës për përfshirjen e tyre në inspirimin, përgatitjet dhe pjesëmarrjen në sulmin terrorist të 24 shtatorit. "Derisa unë jam ulur në tryezën e dialogut në Bruksel dhe në Samitin e Procesit të Berlinit për të bërë marrëveshje për të ardhmen, siç e pamë një javë më parë Serbia po punonte

në plane ushtarake për ta aneksuar territorin tonë", ka thënë kryeministri Kurti, duke shtuar se kjo dëshmon se Serbia nuk është e interesuar për bashkëpunim rajonal për anëtarësim në BE, por më shumë për orientime alternative gjeopolitike që i mundësojnë asaj t'i mirëmbajë ambicet hegjemonike ndaj shteteve përreth.

Ai ka thënë se informatat preliminare të autoriteteve të Kosovës tregojnë se shumica e personave të përfshirë në sulmin ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë janë ose pjesëtarë të organizatës Mbrojtja Civile ose të Brigadës Veriore - të dyja të shpallura terroriste në Kosovë në qershor të këtij viti. Sipas Kurtit, çështja më e rëndësishme aktualisht është siguria e Kosovës dhe ndëshkimi për sulmuesit e Policisë së Kosovës. "Ndëshkimi për sulmuesit nënkupton ndëshkimin e Serbisë, e cila e mbështeti financiarisht, ushtarakisht, logjistikisht,

politikisht, publikisht, zyrtarisht, atë që ndodhi në Banjskë të Zveçanit, në të njëjtën kohë edhe ekstradimi, dorëzimi i të gjithë atyre të cilët janë duke u përndjekur, sepse ikën nga vendi i krimit dhe nga shteti ynë", ka thënë Kurti.

Në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës është mbajtur takimi i përbashkët i kryesisë dhe grupit parlamentar të PDK-së, ku u diskutua për situatën e sigurisë në vend, zhvillimet politike dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet Republika e Kosovës.

Në raport me situatën e sigurisë në vend, Partia Demokratike e Kosovës edhe një herë shpreh mbështetjen e plotë dhe mirënjohjen më të thellë për të gjitha institucionet e sigurisë, posaçërisht për Policinë e Kosovës, e cila ka bërë dhe po bën një punë të jashtëzakonshme dhe shumë profesionale në terren. Për PDK-në tashmë është krejtësisht e qartë se organizimi dhe orkestrimi i sulmit terrorist ndaj Republikës së Kosovës

adresën kryesore e ka në Beograd. "Pjesëmarrja dhe udhëheqja e këtij sulmi nga Millan Radojiçiq, miku dhe bashkëpunëtori i ngushtë i presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i cili sot po strehohet dhe po vepron i lirë në Serbi, vërtetojnë një gjë të tillë. Prandaj, edhe sot u bëjmë thirrje aleatëve tanë ndërkombëtarë që ta rritin presionin ndaj Serbisë për t'i dorëzuar tek autoritetet e Kosovës të gjithë terroristët të cilët Serbia i ka marrë në mbrojtje", është bërë me dije në njoftimin e kësaj partie.

PDK-ja kërkon veçanërisht nga Bashkimi Evropian që të marrë masa ndëshkuese ndaj Serbisë, tashmë kur dëshmitë për përfshirjen e Serbisë në sulmin terrorist kundër Kosovës janë të bollshme.

PDK-ja vlerëson se vendosja e mijëra trupave ushtarake serbe rreth e përqark kufirit me Kosovën tregon qartë se synimet destabilizuese të Serbisë kundrejt vendit tonë nuk kanë përfunduar. Në këtë kontekst, PDK-ja kërkon

AKB-ja thotë se sulmi terrorist në Banjskë la pasoja në ekonominë e Kosovës

PRISHTINË, 3 TETOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka publikuar një studim njëjavor "7 ditë pas sulmit në veri dhe ndikimi në ekonominë e Kosovës".

Agim Shahini, kryetar i AKB-së, ka thënë se AKB-ja gjatë gjithë javës së kaluar ka përcjell nga afër situatën e krijuar nga sulmi diversant ku kishte qëllim ndërrimin e rendit kushtetues në Kosovë dhe atë administrativ në veri. Sipas tij, ky sulm terrorist i përmasës së gjerë kishte synim t'i marrë nën kontrolli pikat vitale në veri të

Kosovës dhe ndarje në lumin Ibër, më pas nga ai pozicion të themelohet Republika Veriore Serbe në Kosovë. "Ky sulm terrorist la pasoja në ekonominë e Kosovës. Frikësoi qytetarët dhe investitorët e huaj. Konsumi i përgjithshëm ra deri në 4 për qind. Bizneset ulën aktivitetin deri në 10 për qind. Vizitat turistike e familjare ranë deri në 50 për qind. Shitja në sektorin e patundshmërisë: banesave e lokaleve ra në 50 për qind. Pagesa e ratave të banesave të blera ra mbi 40 për qind. Interesimi për investime

të huaja në Kosovë ra në 0 për qind gjatë javës 24-30 shtator", ka thënë Shahini.

Kryetari i AKB-së ka theksuar se Kosova ka pasur humbje të qarkullimit rreth 20 milionë euro. Sipas tij, konsiderohet se Kosova ishte humbësja më e madhe ekonomik gjatë javës së kaluar dhe përfituesja më e madhe politike e diplomatike pas luftës e këndeje. Sipas Shahinit, kështu Kosova ndërroi rolin e vet në arenën ndërkombëtare, të cilët neve na sanksionuan e na kritikuan për mosdialog dhe mospërmbushje

të marrëveshjes me Serbinë.

Kryetari i AKB-së ka pohuar se deri këtë kohë Serbia luajti rolin e viktimës, por duke përgatitur alternativë tjetër aksionin terrorist si opsion real për t'i arritur qëllimet e veta destabilizuese dhe sunduese në veriun e Kosovës. "AKB-ja kërkon nga institucionet shtetërore dhe politike të bëhen bashkë për të mirën e sigurisë dhe zhvillimit të shtetit. AKB-ja i fton të gjitha partitë politike t'i ulin flamujt politikë dhe ta ngrehin atë të shtetit të Kosovës", është shprehur

Shahini.

Ndërsa njohësi i ekonomisë, Mustafë Kadriaj, ka thënë se qëllimi i Serbisë është që ta dëmtojë Kosovën ekonomikisht. "Është shumë e nevojshme të vlerësohet ekonomikisht situata. Interesat politike kanë pluset dhe minuset e tyre, por në një kohë afatgjatë po dëmtohet interesi ekonomik. Që nga pas lufta ekonomia ka mbetur nën hije. Edhe Serbia e ka këtë qëllim, që ta dëmtojë Kosovën ekonomikisht", ka thënë Kadriaj.



koordinim më të madh të Qeverisë së Kosovës me aleatët strategjikë, para së gjithash me ShBA-në.

Në të njëjtën kohë, PDK-ja ka theksuar se është mirënjohëse për përkushtimin dhe mbështetjen e aleatëve tanë ndaj Republikës së Kosovës në këtë situatë të vështirë për shtetin dhe popullin tonë. "Për PDK-në interesi nacional i vendit mbetet mbi të gjitha, posaçërisht në periudha sfiduese si kjo, kur është cenuar integriteti territorial, sovraniteti i shtetit tonë dhe siguria e qytetarëve tanë", thuhet në njoftimin e PDK-së.

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se shtimi i numrit të pjesëtarëve të KFOR-it brenda mandatit që ka dëshmon vendosmërinë e NATO-s se terrorizmi nuk kalon. "Paqja në Kosovë e në Ballkan është vendosur me shumë dhimbje e tragjedi, prandaj nuk do të lejohet askënd që ta rrezikojë atë.

Si Kosovë qëndrojmë fuqishëm në mbështetje të të drejtave politike të të gjitha komuniteteve, edhe të komunitetit serb, në bazë të Kushtetutës, ligjeve të Kosovës dhe në bazë të planit franko-gjerman të përkrahur nga Amerika", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka theksuar se faktet që po zbardhen përditë dëshmojnë për implikimin e thellë të Serbisë në organizimin e akteve terroriste në veri dhe shteti i Serbisë nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. "Prandaj kërkohet një hetim ndërkombëtar për t'i zbardhur skenarët e destabilizimit jo vetëm të Kosovës, por edhe të Ballkanit dhe për t'i nxjerrë para drejtësisë të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në këto sulme terroriste", ka thënë Haradinaj. Policia e Kosovës po kryen hetime në zonën malore të Banjskës. Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës, Veton Elshani, ka thënë se në operacionin e së martës, policia, përfshirë njësitin special,

është në kërkim të armëve. Megjithatë, ai ka njoftuar se kontrollat e shtëpive në atë zonë nuk janë pjesë e operacionit. "Sapo i kemi tërhequr njësitet speciale nga Banjska, do të thotë niveli i rrezikut ulet, por na duheshin më shumë njerëz. Nuk është e pazakontë. Po mundohemi ta çojmë aksionin deri në fund, por varet nëse do të gjendet diçka", ka thënë Elshani për Radion Evropa e Lirë. Policia e Kosovës ka gjetur sasi të konsiderueshme të armatimit në këtë zonë edhe më 30 shtator. Në mesin e pajisjeve të gjetura janë përmendur: raketahedhës (zolla), armë të gjata dhe pajisje të tjera ushtarake, si jelekë antiplumb. Pas sulmit të 24 shtatorit, zyrtarët policorë kanë ekspozuar edhe granatahedhës, pushkë të shumta automatike, pushkë snajper, automjete ushtarake, eksplozivë, detonatorë, të cilat i kanë gjetur në operacionet e kërkimit në këtë fshat në veri të Kosovës.

Serbia arreston Millan Radoiçiqin, i caktohet masa e paraburgimit për 48 orë



Ministria e Brendshme e Serbisë ka njoftuar të martën se ka kontrolluar banesën dhe ambientet e tjera të Millan Radoiçiqit dhe se atij i është shqiptuar masa e ndalimit për 48 orë. Sipas njoftimit, Radoiçiqi u dërgua në Prokurorinë e Lartë Publike në Beograd me kallëzim penal. Aty nuk jepen detaje të tjera. Më 29 shtator Radoiçiq mori përgjegjësinë për organizimin e sulmit në Banjskë në veri të Kosovës.

Policia kërkon kujdes nga shoferët: Si pasojë e mjegullës po shkaktohen aksidente të shumta

PRISHTINË, 3 TETOR - Policia e Kosovës u ka bërë thirrje pjesëmarrësve në trafik për kujdes dhe përshtatje të shpejtësisë ndaj kushteve në rrugë, sidomos kur ka mjegull. “Kërkohe

vëmendje e shtuar gjatë ngasjes kur ka prezencë të mjegullës e cila ndikon në zvogëlimin e dukshmërisë. Çdo vit, si pasojë e mjegullës që shfaqet në rrugë, shkaktohen aksidente të

shumta. Mos harroni se ngasja në mjegull mund të jetë e rrezikshme. Mbani në vëzhgim rrugën për ndryshime të papritura të dukshmërisë”, ka njoftuar Policia e Kosovës.



Komuna e Rahovecit mban dëgjim publik për shpronësimin e pronës së paluajtshme

RAHOVEC, 3 TETOR - Nën organizimin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të martën në sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec është mbajtur dëgjimi publik me qytetarë me qëllim të njoftimit nga afër me procedurat për shpronësim për interes publik të pronës së paluajtshme ish-shoqërore N. Sh. “Jugopetroll” dhe objektin që menaxhohet dhe administrohet nga AKP-ja që është në pronësi të komunës së Rahovecit. Në njoftimin e kësaj komune theksohet se ky shpronësim është i nevojshëm për realizimin e projektit “Ndërtimi i Sheshit

Qendror të Qytetit” Zona Kadastrale Rahovec. Në këtë dëgjim kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga niveli lokal, drejtori i DGJKP-së, Afrim Oruqi, ai i Urbanizmit, Albnor Mullabazi dhe zyrtarë të tjerë. Të pranishmit në këtë dëgjim publik janë njoftuar për së afërmi me parcelat, duke dhënë qëndrimet e tyre për detajet, kërkesat dhe rekomandimet e tyre. Samir Bruqi, zyrtar i lartë i Departamentit të Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, ka thënë se vlerësimet e pronave do të bëhen në përputhje me Ligjin e Shpronësimit.



Nis punën shërbimi stomatologjik në QMF-në e fshatit Tërstenik të Drenasit



Drenas, 3 tetor - Ka nisur punën shërbimi stomatologjik në QMF-në e fshatit Tërstenik të Komunës së Drenasit, i cili do të ofrohet për banorët e këtij fshati si dhe

fshatrave përreth. Nisjen e shërbimit e ka njoftuar Drejtoresha e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në komunën e Drenasi, Lumnrije

Krapi, e cila ishte për vizitë në këtë qendër. Shërbimi stomatologjik në këtë qendër do të ofrohet çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 15:00.

Drejtoresha e këtij dikasteri theksoi se janë duke vazhduar procedurat e hapjes së shërbimit stomatologjik edhe në dy QMF-të e tjera, atë në Komoran dhe Arllat.

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale mbetet e përkushtuar për ofrimin e shërbimeve për të gjithë banorët e komunës sonë.

Peja, komuna e radhës që përdori inteligjencën artificiale në seancën e rregullt të Kuvendit

PEJË, 3 TETOR - Komuna e Pejës është bërë një nga komunat e para që ka transkriptuar me inteligjencën artificiale seancën e rregullt të Kuvendit Komunal. “Komuna e Pejës bëri një hap të rëndësishëm drejt të ardhmes duke përdorur inteligjencën artificiale për të transkriptuar

seancën e Kuvendit të Komunës së Pejës të datës 29.09.2023, ku u diskutua dhe u aprovua buxheti i komunës për vitin 2024, ky transkriptim u bë në vetëm 20 minuta. Përmes ‘Shqip.ai’ arritëm të diskutimeve të pikave të rendit të ditës e edhe miratimit të

buxhetit për vitin 2024 në Kuvendin Komunal të Pejës në vetëm 20 minuta, duke mbuluar një saktësi prej mbi 95 për qind”, ka njoftuar komuna e Pejës. Edhe Komuna e Prishtinës ka transkriptuar me inteligjencën artificiale një nga seancat e Kuvendit Komunal.



Kurti u kërkon komuniteteve të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryeministri Albin Kurti u ka bërë thirrje të martën komuniteteve joshumicë në Kosovë që të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë që pritet të fillojë më 1 nëntor. Në këtë mënyrë, Kurti ka thënë se qeveria do të mund të bëjë më mirë planifikime se sa shkolla u duhen komuniteteve, sa kilometra rrugë e ku të investojmë në ekonomi. Në një takim me zyrtarë komunalë për komunitete dhe kthim, ai ka përmendur edhe disa nga veprimet e qeverisë për

komunitetet. "Qeveria më e mirë është ajo më afër popullit. Jemi mirënjohës që ju kemi si zyrtarë komunalë për komunitete dhe kthim afër qytetarëve tanë. Prandaj e kemi organizuar këtë takim për herën e pestë që ju të keni mundësi t'i shprehni mendimet tuaja. Kemi ndarë 3 milionë euro për komunitetet joshumicë. MAPL-ja ka ndarë 1 milion euro për projekte infrastrukturore, veçanërisht për komunitetet. Ministria e Mjedisit i ka identifikuar 29 projekte, 9 prej të cilave janë

për komunitetet joshumicë. Një e arritur tjetër është edhe njohja e gjuhës rome si gjuhë zyrtare në Prizren. Kemi edhe linjën e re të autobusëve nga Prishtina në Kishnicë dhe Graçanicë, linjë që u hap dje. Prioritet u kemi dhënë edhe vizitave në terren. Regjistrimi i popullsisë do të fillojë më 1 nëntor. Është obligim i çdo qytetari që të marrë pjesë në këtë proces. Me informatat që do të mblidhen nga regjistrimi do të kemi mundësi të planifikojmë për nevojat e komuniteteve se sa shkolla na duhen, sa



kilometra rrugë dhe ku të investojmë në ekonomi. Kam ardhur të dëgjoj prej juve, për juve dhe për vendin tonë", është shprehur kryeministri Albin Kurti.

KDI-ja: Vetëm 17 për qind e qytetarëve dinë se mund të përfshihen në reformën e drejtësisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të martën konferencë për medie në të cilën janë paraqitur rezultatet e hulumtimit të opinionit publik që pasqyrojnë këndvështrimet e qytetarëve të Kosovës mbi reformën në sistemin e drejtësisë.

Gjatë shpalosjes së të dhënave, Violeta Haxholli nga KDI-ja sqaroi se hulumtimi vë në pah këndvështrimin e qytetarëve rreth performancës së sektorit të drejtësisë, konkretisht punën e prokurorive dhe gjykatave. Pastaj pritjet e qytetarëve për përmirësime në këtë sektor, institucionet përgjegjëse për reforma në këtë sektor si dhe mundësitë e qytetarëve për t'u përfshirë në këtë reformë.

Në pyetjen nëse qytetarët kanë parë përmirësime këtë vit në punën e prokurorive dhe gjykatave, qytetarët janë ndarë në dysh. Kështu, 44 % e qytetarëve mendojnë se deri diku ka pasur përmirësime në performancën e sektorit të drejtësisë, derisa 36 %



mendojnë se nuk ka pasur fare përmirësime. Vetëm 10 % e qytetarëve mendojnë se sektori i drejtësisë ka shënuar përmirësime. Në pyetjen e dytë qytetarët janë pyetur se kur presin ata që të ketë përmirësime në punën e sektorit të drejtësisë, konkretisht në punën e prokurorive dhe gjykatave. Lidhur

me këtë vetëm 8 % e qytetarëve presin përmirësime gjatë këtij viti. Shumica prej tyre, konkretisht 38 %, presin përmirësime gjatë 5 viteve të ardhshme dhe 31 % e tyre në 10 vitet e ardhshme.

Haxholli vijoi prezantimin e të dhënave me pyetjen e tretë që u është parashtruar qytetarëve lidhur

me atë se kush mendojnë ata se e ka përgjegjësinë kryesore për ta reformuar/përmirësuar sektorin e drejtësisë (prokuroritë dhe gjykatat). Në përqindjen më të lartë konkretisht 36 %, qytetarët janë të mendimit se përgjegjësinë kryesore për reformë në këtë sektor e kanë vetë institucionet e drejtësisë,

ndërsa si institucionin e dytë përgjegjës e kanë radhitur qeverinë, me 34 %.

Lidhur me atë se a janë të informuar qytetarët për mundësitë e tyre për të marrë pjesë në diskutime gjatë hartimit/shqyrtimit të projektligjeve për reformimin e sektorit të drejtësisë, në përqindje shumë të lartë, me 77 %, qytetarët janë shprehur se nuk janë të informuar. Vetëm 17 % e tyre janë shprehur se e kanë këtë informacion.

Në fund, qytetarët janë pyetur edhe lidhur me preferencat e tyre për t'u përfshirë në procesin e shqyrtimit të projektligjeve të reformës në drejtësi.

Lidhur me këtë çështje, 76 % e qytetarëve janë deklaruar se nuk preferojnë të përfshihen në këtë proces. Në anën tjetër 18 % e tyre janë shprehur se preferojnë të përfshihen përmes pjesëmarrjes në diskutime publike.

Ky hulumtim i opinionit publik është realizuar me metodën e Omnibusit, në të cilin kanë marrë pjesë 1065 respondentë të moshës mbi 18 vjeç. Periudha e anketimit përfshin datën nga 4 deri më 13 shtator të këtij viti.

SBASHK-u ankohet tek Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës për qeverinë Kurti

PRISHTINË, 3 TETOR - Pasi kishin marrë pjesë në punimet e Kongresit Zgjedhor të Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë në Tiranë, kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, bashkë me nënkryetarin Vjollca Shala dhe koordinatoren për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, janë takuar me kryetarin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Larry Flanagan, të cilin e kanë informuar për aktualitetin në arsimin e Kosovës dhe për angazhimet në shërbim të anëtarësisë, por edhe për sfidat e shumta të kohës duke u fokusuar te qasja e gabueshme e qeverisë ndaj

sindikatave dhe te mungesa e dialogut me fajn e institucioneve qendrore të Kosovës. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë kërkuar nga kryetari Flanagan të ngrehë në organet e Unionit, që përfaqëson 11 milionë anëtarë, por edhe në institucione të tjera, shqetësimin se Qeveria e Kosovës, duke tërhequr vazhdimisht vëmendjen e opinionit me rrjedhën e dialogut me Serbinë, po vazhdon përpjekjet për shuarjen e zërit sindikal, duke mos ndalur goditjet ndaj sindikatave dhe duke mohuar dialogun me to.

Kryetari Flanagan e ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe është shprehur se ka shumë informacione për angazhimet dhe sfidat, informacione këto të cilat i ka marrë nga drejtoresha e përgjithshme e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Suzan Flocken dhe se SBASHK-u e ka pasur dhe e ka mbështetjen e fuqishme të ETUCE-s në të gjitha angazhimet për mbrojtjen e të drejtave të anëtarësisë dhe realizimit të kërkesave të tyre legjitime. Flanagan ka shprehur shqetësimin e tij dhe të Unionit që përfaqëson për



qasjen e gabuar të Qeverisë së Kosovës ndaj sindikatave dhe dialogut dhe i ka siguruar përfaqësuesit e SBASHK-ut se këto shqetësime do t'i

prezantojë edhe në takimet e organeve të ETUCE-s në Bruksel, por edhe në institucionet ndërkombëtare që merren me dialogun social.

PDK-ja dhe LDK-ja kritikojnë ministrin Murati, shkak inflacioni dhe të hyrat

PRISHTINË, 3 TETOR - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka adresuar një varg kritikash në adresë të ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati.

Bajrami ka thënë se të hyrat financiare janë rritur për shkak të inflacionit. "Nëse një produkt ka kushtuar 1 euro dhe TVSh-ja është 18 për qind, atëherë shteti i ka inkasuar 18 centë dhe nëse produkti është rritur në 1.50, atëherë i keni inkasuar 27 centë dhe arsyeja e rritjes së të hyrave

është inflacioni. Dhe gjithë kjo i bie në kurriz të qytetarëve", ka thënë ajo.

Pas kritikave të Bajramit, ka reaguar deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Mirlinda Tishukaj-Sadriu. Ajo ka thënë se për shkak të neglizhencës, Vitia është lënë pa u kyçur në autostradë dhe tani një gjë të tillë është duke e bërë qeveria Kurti. "Kyçja e Vitisë në autostradë nuk është bërë për 12 vjet dhe është lënë për shkak të 2 milionë eurove anash. Është pikërisht LDK-ja që Ligjin për

Çmimin për Tavan e ka dërguar në Kushtetuese dhe pikërisht një kryetar komune nga PDK-ja e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese Ligjin për Tatimin në Pronë", ka thënë ajo.

Ndërsa deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hajdar Beqa, ka thënë se gjetjet e vitit 2021 me atë të vitit 2022 janë të njëjta. Ai si shembull ka marrë pagesat e qytetarëve serbë të punësuar në bazë të marrëveshjes së Brukselit, të cilët paguhën pa shkuar në punë.



"Procesi i Berlinit duhet ta ndihmojë konsolidimin tonë demokratik dhe zhvillimin ekonomik"

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në tryezën e diskutimit "Procesi i Berlinit: arritjet e deritanishme, pritjet nga samiti i ardhshëm dhe përfitimet e mundshme nga Iniciativa e Përbashkët e Tregut Rajonal" organizuar nga Instituti i Prishtinës për Studime Politike (PIPS), në bashkëpunim me HD - Qendra për Dialog Humanitar.

Dy javë para Samitit të Procesit të Berlinit në Tiranë, kryeministri Kurti theksoi rëndësinë e këtij takimi për të diskutuar se çfarë po bën qeveria për zbatimin e angazhimeve të marra, por edhe për të ofruar transparencë për qytetarët.

Nënshkrimi i tri marrëveshjeve të lëvizshmërisë vitin e kaluar në Berlin, sipas kryeministrit, shënon një hap të madh përpara për rajonin, derisa tha se Procesi i Berlinit duhet të ndihmojë konsolidimin tonë demokratik dhe zhvillimin ekonomik, pasi që angazhimi ynë në rajon dhe në botë pasqyron punën tonë në shtëpi. "Ne kemi treguar se ajo që Republika e Kosovës sjell në Procesin e Berlinit është një përkushtim i vendosur për lirinë dhe demokracinë, qeverisjen e mirë dhe sundimin e ligjit", theksoi ai, duke përmendur faktin që Kosova është vendi i parë që i ka ratifikuar tri marrëveshjet e nënshkuara në Berlin në kuadër të këtij procesi.

Kryeministrit përmendi edhe



faktin se Kosova është radhitur e para në Ballkanin Perëndimor për përmirësimin e sundimit të ligjit nga Projekti Botëror i Drejtësisë; përmirësimin e të drejtave politike dhe lirive civile nga Freedom House; përmirësimin e luftës kundër korrupsionit nga

Transparency International; lirinë e shtypit nga Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit nga Reporterët pa Kufij; demokracinë liberale dhe elektorale nga indeksi i Varieteteve të Demokracisë të Institutit V-Dem; për mbledhjen e të ardhurave tatimore nga FMN;

si dhe për paketën më të madhe fiskale për t'i ndihmuar qytetarët të përballen me krizën ushqimore dhe energjetike dhe të luftojnë inflacionin nga Banka Botërore. Në pritje të Samitit të Tiranës, kryeministri përmbylli fjalën e tij duke theksuar nevojën për vlera

dhe qëllime të përbashkëta, zbatimin e plotë të marrëveshjeve që nënshkruam vitin e kaluar, më 3 nëntor në Procesin e Berlinit dhe një angazhim të ri që largon edhe më tej barrierat midis gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Telekomi, probleme me pajisje, ndërpriten thirrjet, konsumatorët ankohen

PRISHTINË, 3 TETOR - Telekomi i Kosovës i ka njoftuar konsumatorët se rënia e përgjithshme e shërbimeve në mëngjesin e së martës është shkaktuar si pasojë e vjetërsisë së pajisjeve. Përmes një komunikate për medie, Telekomi ka thënë se pajisjet do të ndërrohen shpejt, pa përmendur afate kohore. Sipas kompanisë, ekipet e saj teknike janë duke punuar për t'i rikthyer shërbimet te qytetarët. Disa prej tyre janë ankuar në

rjetet sociale për mungesë shërbimesh.

Telekomi i Kosovës është kompani publike, e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo mobile, Vala.

Operatori Vala ka mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi. Në këtë kompani janë të punësuar rreth 2 500 punëtorë.

Telekomi i Kosovës dikur ka qenë kompania më fitimprurëse në Kosovë, mirëpo kohën e fundit

është përballur përkeqësim të situatës financiare. Kjo situatë, sipas ekspertëve të telekomunikacionit, ka ardhur si pasojë e kontratave të dëmshme, vendimmarrjes së gabuar, mungesës së investimeve, ndërhyrjes së politikës në vendimmarrje strategjike të kompanisë dhe nepotizmit. Telekomi i Kosovës i është nënshtruar dy herë procesit të privatizimit, mirëpo asnjëri prej tyre nuk është finalizuar me sukses.



Kujtimet e oficerit britanik: Ndaj kundërshtarëve, Enver Hoxha ishte i pashpirt

– Dëshmia e vitit 2003 e ish-komandant ushtarak të kampit stërvitor të diversantëve shqiptarë në Maltë, David Smiley –



David Smiley (majtas) dhe "Billy" McLean në Shqipëri më 1944

Nga: Sokol GRUDA

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, punoi me Enver Hoxhën dhe Abaz Kupin, për organizimin e forcave antifashiste. Me rënien e "Perdes së Hekurt", stërviti diversantë, për të rrëzuar regjimin komunist. Mbrëmjen e 28 nëntorit 2003, në një pritje të Shoqatës Anglo-Shqiptare në Londër, qëlloi të më prezantonin në shqip, me një burrë në moshë që kishte zënë vend në atë cep të sallës ku rrinin "të zotët e shtëpisë". Nga tingëllimi i mbiemrit të tij, përzierë me trokitje gotash e copëza bisedash, mendova se kisha takuar babanë e ndonjë prej bashkatdhetarëve në atë pritje. "Jam Dejvid Smajli [David Smiley]", sqaroi thjesht, duke më shtrënguar dorën. "Kolonel Dejvid Smajli", vazhdoi, si për të zhdukur çdo keqkuptim. Këmbyem kartëvizitat dhe e lamë të shihemi një herë tjetër. "Ndoshta për një intervistë?" – provova unë me guxim shansin. "Ndoshta diku, ku të jetë më qetë", tha, duke drejtuar gishtin tek aparati i dëgjimit në vesh. Kur e takova prapë kolonel David Smiley, rrugët e Londrës qenë mbushur me posterat e 60-vjetorit të fitores mbi fashizmin në Evropë. Në Shqipëri ndoshta kishin filluar edhe përgatitjet për shënimin e 15-

vjetorit të rrëzimit të diktaturës. Nuk kishte asnjë moment më të mirë për të takuar kolonel Smiley, që, për fatin e tij të mirë a të keq, ka lënë gjurmë në të dyja këto ngjarje.

Dy krahët e shqipes

Në katin e dytë të apartamentit, në një lagje të qetë në perëndim të Londrës, derën ma hap vetë kolonel Smiley. Mbështetet lehtës në një bastun modest, por dorën ma shtrëngon fort dhe sytë nuk i lëvizin teksa më uron mirëseardhjen. Rehatohe mi në dhomën e ndenjës dhe koloneli më gostit me raki shqiptare, të cilën ia kanë sjellë miqtë e tij shqiptarë. Biseda bëhet më e këndshme pas kësaj surprize të vogël. Fillojmë të flasim për ngjarje që zunë fill një çerek shekulli pa lindur unë, në një vend të panjohur për të: "Shqipëria ishte e pushtuar nga armiqtë tanë, italianët. Dukej vend mjaft primitiv, i egër, por shumë tërheqës, veçanërisht në zonat malore ku kalova pjesën më të madhe të kohës. Si luftëtar gueril, nuk mund të kisha gjetur vend më të mirë për të punuar. Unë bëja pjesë në organizatën SOE (Special Operation Executive), me qendër në Kajro. SOE, organizonte hedhjen në Ballkan të trupave britanike dhe shtetasve nga ata vende, me synim minimin e

operacioneve ushtarake gjermane dhe shkaktimin e sa më shumë dëmeve në trupat e tyre. Bashkë me shokun tim Billy McClain, ramë dakord të shkonim në Shqipëri, një vend ku nuk kishte shkelur askush nga organizata jonë. Ishte prill i vitit 1943, kur hymë në Shqipëri nga Greqia, pas dy ditësh rrugë në këmbë", kujtoi Smiley ato ditë të trazuarat. Së bashku me kolegun e tij, McClain, kishin parapëlqyer rrugën më të gjatë, për t'iu shmangur, siç tha, "parashutimit symbyllurazi, në duart e fashistëve". Për shqiptarët kishte dëgjuar se ishin bujarë e mikpritës. "Shqiptari i parë që takuam, ishte komisar i një çete, të cilit nuk i pëlqyem dhe na kërkoi të largoheshim. Na u desh të dilnim nga Shqipëria, por unë u ktheva përsëri nëpërmjet një rrugë tjetër dhe hyra në afërsi të Korçës. Më vonë, kur mësuam se neve mund të na vinin furnizime nga ajri, partizanët filluan të shfaqnin me shumë interes për ne, madje edhe na ftuan. Për nëntë muaj, punuam bashkë me partizanët e udhëhequr nga Enver Hoxha. Pas takimit me çetën e parë partizane, na u bë shumë e vështurë hyrja në kontakt me dikë tjetër, sepse partizanët, bënëin ç'është e mundur që ne të mos u afroshim kundërshtarëve të tyre politike, ballistëve, apo

zogistëve të Abaz Kupit. Enver Hoxha drejtonte Partinë Komuniste. Me të punova gjatë pjesës më të madhe të 8-9 muajve, duke e ndihmuar në armatosjen e çetave të ndryshme, kryesisht në Jug të vendit, në afërsi të Korçës dhe zonave përreth". "Për Enver Hoxhën krijova antipati, thuajse që në takimin e parë. Ishte e qartë se as ai nuk kishte ndonjë konsideratë për ne, por na toleronte, ngaqë e dinte se do ta ndihmonim për krijimin e çetave partizane. Hoxha ishte gjaknxehtë dhe shpeshherë jam zënë me të. Megjithatë ishte tip që bërtiste e zemërohej, unë kam punuar me të, që nga prilli i vitit 1943, e deri në largimin tim në tetor-nëntor të po atij viti", kujtoi ish-kapiteni britanik. "Në një rast ai u inatos keqas, sepse pa lejen e tij, hodha në erë një urë. I thashë se kisha ardhur në Shqipëri, për të luftuar italianët e gjermanët. Enver Hoxha këmbëngulte se duhej të isha autorizuar prej tij. Unë i shpjegoja se nuk isha nën komandën e tij, se isha oficer britanik dhe urdhrat i merrja nga Shtabi im në Kajro, e më vonë në Bari". Kolonel Smiley ka thënë se ka pasur përvoja të këqija edhe me figura të tjera komuniste të luftës në Shqipëri. Me albumin e fotove në dorë, ndalet tek portreti i pagabueshëm i një partizani, me

mustaqe. "Mehmet Shehu! Armiku im për vdekje! Veçse fliste shumë mirë anglisht, për të mos ia ngrënë hakun". Sidoqoftë, mosmarrëveshja me komunistët shqiptarë, nuk duhet të ketë qenë shtysa e vetme e largimit të përkohshëm të misionarit Smiley dhe kolegut të tij McClain. "Pas 8-9 muajsh në Shqipëri, unë u evakuova dhe u ktheva në Angli. Bashkë me kolegun Bill McClain, takova ministrin e Jashtëm, Antony Eden, i cili na tha: 'Kthehuni në Shqipëri dhe përpuni organizonin familjet, kryesisht katolike të Veriut, në luftë kundër gjermanëve'". "Nuk kaloi shumë kohë dhe na parashutuan në një vend kodrinor, në afërsi të Tiranës. Gjashtë muaj qëndruam me forcat e Abaz Kupit dhe me disa çeta të 'Ballit Kombëtar'. Zhvilluam disa luftime. Mesa mbaj mend në atë periudhë, partizanët nuk luftonin, me përjashtim të rasteve kur sulmoheshin. Kur ishim akoma në Veri të vendit, britanikët dërguan një komando në Shqipërinë e Jugut. Gjermanët po tërhiqeshin nga Greqia dhe ne donim t'i copëtonim forcat e tyre. Por, me urdher nga Enver Hoxha, komisar i zonës nuk pranonte të bashkëpunonte me britanikët. Forcat e Hoxhës e dinin se unë dhe McClain ishim antikomunistë ndaj

bënin çmos të na hiqnin qafe. Erdhi një kohë kur vunë edhe shpërblim për kokën tonë. Për ca kohë, derisa u larguam nga deti, na u desh të ruheshim si prej gjermanëve, ashtu edhe prej partizanëve”.

Por, jo çdo gjë ishte në duart e vetë përvojës ushtarake dhe nuhatjes politike të Smileyt. Shtabi britanik kishte vendosur të mbështeste forcat e Enver Hoxhës dhe një ushtarak si Smiley, që kishte ndihmuar antikomunistët, mund të vazhdonte të qëndronte sërish në Shqipëri. “U larguam të indinjuar. Shtabi ynë kishte vendosur t’ia kalonte të gjitha ndihmat komunistëve dhe të tërhiqte oficerët britanikë nga trupat e Abaz Kupit dhe Ballit Kombëtar”, kujton Smiley.

Derisa misioni britanik shumëfishoi ndihmën për komunistët, David Smiley, i pari ushtarak aleat i hedhur nga Shtabi i Operacionit SOE në Shqipëri, u largua i zhgënjyer dhe plot indinjatë.

Në kollukët e dhomës së tij të ndenjës, kolonel Smiley pranoi se vendimi i shtabit të tij, mund të ketë qenë i imponuar nga rrethanat. “Ballistët e zogistët nuk i luftuan shumë gjermanët, sepse ndoshta pritën të shihnin se çfarë drejtimi do të merrte lufta”.

Por, edhe 60 vjet pas përfundimit të luftës, Smiley nuk ka ndërruar mendje për krahun e djathtë të luftës në Shqipëri. Një qylaf i bardhë me shkabë, është ndër sendet e para që të kap syri, në hyrje të apartamentit të tij.

“Janë të shumtë ata që nuk janë dakord me mua, por ka plot të tjerë që mendojnë si unë. Sikur gjatë luftës të kishim përkrahur të djathtët, ata do të kishin luftuar, gjë që nuk e bënë. Ata ishin mjaft të stërvitur dhe kishin oficerë nga xhandarmëria. Mendoj se me të vërtetë do të kishin pasur sukses, sikur britanikët të mos kishin vendosur, papritur, t’ia kalonin gjithë ndihmat Enver Hoxhës”.

Por, a pajtohej kolonel Smiley me

mendimin, se pjesa më e madhe e rreth 30 mijë shqiptarëve të vrarë gjatë luftës ishin në krahun e komunistëve dhe jo të kundërshtarëve të tyre të djathtë? Pyetja e bëri të heshtte, për një moment. Nuk u përgjigj menjëherë, por ka dëgjuar.

“Mendoj se Enver Hoxha, ishte fare i pashpirt në luftën për eliminimin e kundërshtarëve politikë, edhe kur akoma nuk i kishte marrë frenat e vendit në dorë”, filloi të përgjigjej ish-kapiteni i kohës së Luftës dhe vazhdon: “Partizanët vranë shumë ballistë e zogistë dhe, kur u larguam ne, vendi ishte në luftë civile. Mua më vjen keq ta pohoj, por komunistët fituan. Ata fituan, sepse kishin armë më të mira, ishin stërvitur më mirë dhe kishin më shumë përvojë në male. Ata ishin të pajisur më mirë, falë ndihmës që morën nga britanikët.”

Pse nuk patën sukses përpjekjet për të larguar nga pushteti udhëheqësin komunist. Kush tradhtoi dhe roli i Abaz Ermenjit dhe Abaz Kupit?!

Matanë perdes së hekurt

Hyrja e partizanëve në Tiranë, mund të dukej vërtetë si një togë festive në marshimin e madh të aleatëve fitimtarë. Por, parada e kuqe, që niste nga brigjet e Baltikut, kishte mbërritur në Adriatik. Në vitin 1946, Winston Churchill diagnostikon në këtë mënyrë gjendjen e Evropës së pasluftës: “Një perde e hekurt ka rënë përmes kontinentit”!

Kur e kuptuan se çfarë po ndodhte në Shqipëri, krerët e Smileyt në Londër hapën sërish hartat e vjetra të luftës. Enver Hoxha duhet të hiqej, nga vetë njerëzit e vet. Operacioni kishte nevojë për bazë politike dhe ushtarake. Në fushë u sollën sërish lojtarët me përvojë. Ishte pikërisht vjeshta e vitit 1949, kur emri i ish-misionarit, David Smiley, u lidh sërish me Shqipërinë. Ai u emërua komandant ushtarak i kampit stërvitor të diversantëve në Maltë.

“Ishte operacion i përbashkët anglo-amerikan. Asokohe ishte formuar Komiteti ‘Shqipëria e Lirë’, kryesisht me njerëz të Abaz Ermenjit dhe Abaz Kupit. Ata kishin vendosur dërgimin e disa shqiptarëve të larguar pas luftës në Shqipëri, për të parë mundësitë e minimi të regjimit të Enver Hoxhës. Mua më ngarkuan detyrën e stërvitjes së këtyre shqiptarëve, në Maltë. Pas ca kohe, ata u hodhën në Shqipëri nga deti. Fatkeqësisht, shumica e tyre u kapën, vetëm pak shpëtuan. U kuptua se, në shumicën e rasteve, atyre u zinin pritë. Arsyet do të merreshin vesh më vonë. Meqenëse ne bashkëpunonim me amerikanët, duhet t’u tregonim atyre se çfarë po bënim. Vetë amerikanët kishin filluar parachutimin e desantëve në veri të Shqipërisë, ndërsa unë operoja në jug duke i dërguar desantët e mi nga deti. Ndodhi që personi që mbante lidhjet mes britanikëve dhe amerikanëve, në Uashington, ishte një agent, më emrin Kim Philby. Ai ua dërgonte gjithë informacionet rusëve, të cilët më tej, ia kalonin Enver Hoxhës. Prandaj, Hoxha i njihje veprimet tona me saktësi. Ne na preu në besë një tradhtar britanik”!

Kolonel Smiley, nuk harroi të theksojë, edhe njëherë, cilësitë e shqiptarëve që stërviti për shumë vjet në kampin e Maltës. “Të gjithë njerëzit që hidheshin në Shqipëri, ishin patriotë dhe shumë guximtarë. Mua më erdhi jashtëzakonisht keq kur mësova për fatin e tyre. Ata ishin rekrutuar nga Abaz Ermenji dhe një pjesë nga Abaz Kupi. Rekrutimi ishte bërë mbi baza vullnetare, kryesisht nga kampet e refugjatëve në Gjermani, ku ishin përqendruar shumë shqiptarë. Më pas ata erdhën tek unë në Maltë, për t’u stërvitur si guerilë. U ndjeva thellësisht i zhgënjyer, kur mësova se i kishin kapur. Ata që kishin arritur të shpëtojnë, erdhën në Greqi dhe na treguan se si kishin rënë në pritë. Sipas tyre, kjo kishte ndodhur ose për shkak të shkeljes së masave të

sigurisë, ose ngaqë dikush i kishte tradhtuar. Unë nuk dija ç’t’ju thosha. E vërteta u mësova vetëm më vonë, kur fillimisht dy agentë (Guy Burghes dhe Donald MacLain) e më vonë Philby, u arratisën në Moskë. Ne na kishin tradhtuar”.

Britanikët ishin të parët që pranuan se operacioni kishte dështuar dhe përpjekjet për të shkaktuar trazira në Shqipëri, duheshin ndërprerë. Organizatorëve nuk u kishte ndihmuar as përvoja e vetë dhe as modelet në vendet fqinjë:

“Të njëjtat probleme, kishin ekzistuar edhe në Greqi e Jugosllavi. Në të dy rastet, kishte pasur përballë dy kundërshtarë të ashpër politikë, të djathtët dhe komunistët. Në të dy rastet, pati luftë civile. Në Jugosllavi ne mbështetëm Titon, kundër Mihajloviqit që unë mendoj se ishte vendim i gabuar ... Fatmirësisht, përkundër këshillave të amerikanëve, në Greqi ne dërguam trupa të cilat ua bllokuan komunistëve rrugën drejt marjes së pushtetit. Kjo është arsyeja se pse Greqia nuk mbeti matanë perdes së hekurt, si Shqipëria e Jugosllavia”.

Nga një ishull grek në anën tjetër të perdes së hekurt, kolonel Smiley dhe operativë të shërbimeve të kundërbulimit, regjistronin dëmet e tradhtisë që solli dështimin e operacionit shqiptar. Disa dhjetëra të vrarë, banorë e diversantë. Të dyja palët shqiptare! A ia vlente? Dhe a nuk u lanë në baltë vetë shqiptarët diversantë, nga mjeshtrit e tyre të huaj?

“Mund të them, madje, se ata u lanë në balte edhe nga unë vetë. Në fund të fundit, isha unë ai që, në mirëbesim, i nisa në Shqipëri duke mos e ditur se ishim të tradhtuar. Ata ishin burra shumë guximtarë dhe nuk i gjej dot fjalët, për të shprehur keqardhjen për fatin e tyre ... Grupet e desantëve, zakonisht prej katër vetash, binin në pritë. Ata kapeshin, torturoheshin dhe pushkatoheshin. Operacioni ynë synonte të shihte reagimin e njerëzve ndaj regjimit të Hoxhës. Por, doli se ata ishin aq të frikësuar,

sa nuk mund t’i ndihmonin njerëzit që zbarkonin. Përgjigjja, pra, ishte se nuk ia vlente dërgimi i forcave të tjera, sepse Enver Hoxha e kishte vendin nën kontroll të plotë dhe njerëzit ishin tmerrësisht të frikësuar prej tij. Disa nga desantët që shpëtuan, i takova më vonë në Greqi dhe asnjëri nuk e kishte inatin me mua. Dua të sqaroj se operacioni ishte konceptuar si rikonjicion, për matjen e pulsit të njerëzve. Nuk ishte operacion për minimin e regjimit të Enver Hoxhës. Ishte thjesht një përpjekje paraprake njohëse, për të parë nëse ia vlente ndërmarrja e një operacioni me të madh. Dhe përgjigjja ishte: jo”!

Smiley u kthye në bazën e regjimentit britanik në Gjermani, ku pas dy vjetësh merr vesh hollësitë e plota të arsyeve që sollën dështimin. Më tej, për operacionin shqiptar u fol e u shkrua nga të dy krahët. U përshkrua si “Radiolokë”, “Tradhti e Madhe” dhe u llogarit “Kostoja e një tradhtie”. Operacioni mund të ketë qenë hartuar që prej fillimit, vetëm si “një episod betejë në luftën kundër komunizmit”, por ekzekutuesve të tij u janë dashur vite të pajtohen me dështimin.

Kolonel Smiley, duket se i ka pjekur shumë herë, me qetësinë e duhur, këto suksese e disfata gjatë viteve të kaluara në shtëpinë e tij, në lagjen e qetë në perëndim të Londrës. Tashmë, kur po prek 90 vjetët, e ndjente se dashur pa dashur, është i lidhur me historinë e këtij vendi, edhe pse aventurat me ballistë e partizanë, tashmë janë shumë të largëta.

Ndërsa ngre me fund gotën e rakisë së ardhur nga disa miq shqiptarë, kolonel David Smiley, tregoi se ka komunikuar lirish me të njohurit në Shqipëri, madje se ka qenë disa herë atje. “Tani Shqipëria është transformuar krejtësisht. Por, u desh kaq shumë kohë”, thotë, duke kujtuar se çfarë vlere merr koha në moshën e tij. /Memorie.al/

David Smiley (majtas) dhe “Billy” McLean në Shqipëri më 1944



Mbrapshtia e një kohe

Nga Monika STAFA

Në fundin e viteve 1990, kur studentët dhe rinia shqiptare pushtuan sheshet me thirrjet për ndërrimin e sistemit politik, dy prej kërkësve të tyre parësore qenë: botimi i Aktit Final të Helsinkit dhe i Kartës 77.

Në të ardhmen që po vinte në gojë të shqiptarëve dëgjonim të përsëritej shumë shpesh me admirim dhe me dhimbje njëherësh emri i themeluesit të Kartës së Pragës, Václav Havel. Ai ishte njeriu që kishte shpëtuar popullin e vet me një revolucion të çuditshëm.

Ishte Revolucioni i Kadifënjtë.

Çekë e sllovakë u ndanë me të kaluarën brenda një nate, duke trokitur gotat e shampanjës. Václav Havel, dramaturg, mendimtar i lirë, i dënuar për idetë e tij nga pushteti bolshevik u shfaq në jetën publike si protagonist i së ardhmes pa droje aspak të përqafohej me kreun e ish-komunistëve, Dubček.

Dhe brenda një nate, çekë e sllovakë vendosën të ndaheshin në dy shtete, duke shkrehur në ajër jo krisma automatikësh por fishekzjarre festive. Këto kujtime filmike më erdhën ndër mend teksa po lexoja librin e fundit, novelë po e quaj unë, ndoshta dhe ese, po kjo ka pak rëndësi në këtë përzjerje gjinësh në letërsinë e sotme moderne dhe të pakufi.

'Në kohën e të marrëve', novela- ese e Shaban Sinanit nuk është një novelë e zakonshme. Me një karakter përqeshës për sjelljet e shqiptarëve në një sistem që ata as nuk e njihnin e as nuk e kishin imagjinuar në atë Shqipëri izolacioniste jo vetëm prej mendësisë, ndodhitë historike rreftënjë për një kohë të krisur kur njeriut i pat mbetur liria në dorë dhe nuk dinte se ç'të bënte me të.

33 vjet më vonë duket sikur asgjë

nuk ka ndryshuar. Protagonistët e Lëvizjes së Dhjetorit '90 ende janë të ndarë mbi atë se çfarë qëllimet e kësaj lëvizje arritën të krijojnë. Nisja e procesit demokratik nuk arriti dot të ruante trajektoren e saj. Përvectse një nostalgjie për ato ditë me shumë intensitet politik, social dhe shpirtëror nuk ka mbetur asgjë tjetër. Vjeshta ka hyrë. Dhe sërish do përsëritet e njëjta histori e vjetër. Dhjetori do t'i gjejë të ndarë heronjtë tanë. Pavarësisht se projektujmë personazhe të njohur apo jo prej asaj çfarë na ofron teknologjia e sotme si makineria Artificial Intelligence, lëvizja shqiptare e përmbysjes së komunizmit mbetet ende pa autor. A do të mundet ajo të na japë ndonjë emër? Kjo nuk është tallje sigurisht por një hall i madh që pushton cdo dhjetor një brez të tërë të atyre viteve. E vërteta është se forca e djathtë shqiptare nuk e ka dhe s'mund ta ketë më monopolin e asaj lëvizjeje. Ndoshta se pjesa dërrmuese e lëvizjes së dhjetorit nuk është më në Partinë Demokratike. Ndoshta sepse që në fillim u kuptua se ajo parti nuk mund të përfaqëonte lëvizjen e dhjetorit si një ideal politik, si një ideal reformimi i shoqërisë shqiptare.

Kjo është ndoshta dhe arsyeja pse në aspektin politik gjithcka ka mbetur aty ku ishte. Po të lexosh novelën-ese të Sh. Sinanit e kupton pse duhet të të vijë keq prej padijes shqiptare. Ndaj ti sot buzëqesh kur rreshton ngjarjet një pas një me personazhet që i njeh dhe ua gjen emrin menjëherë ndërsa autori ua ka kursyer rrezikun e përveçimit publik. Ndoshta për etikë. Ndoshta për të qeshur nën zë. Jo me të madhe. E qeshura e turmës është e dënueshme. Kush të dojë mund t'i tallë edhe ashtu, nën zë.

Ashtu si bëra unë.

Të padukshëm tej anës perëndimore të murit të madh, turma qytetarësh nga pjesa lindore e

tij u mbledhën atë kohë të dëgjonin Reganin, me shpresën se tingujt e zërit të tij do të arrinin dhe në anën e tyre. Ndaj kjo ishte arsyeja përse Regan, iu drejtua personalisht, liderit sovjetik, Michail Gorbacov më 12 qershor të vitit 1987 me thirrjen e fuqishme: Mr. Gorbacov, Open that GATE!

Kishin qenë të thella shumë ato punë. Ndërkaq turmat shqiptare bërtisnin cdo mëngjes para rezidencave diplomatike në Tiranë, duam vizat tona. Teksa i lexoj mes rreshtave të Sh. Sinanit këto ndodhi mund të qeshësh por dhe mund të ndihesh i turpëruar për të njohurit tanë që donin të iknin me një formular të vetëm në dyert e një ambasade të huaj që kush e di ç'mendje e çmendur e kish shpikur për njeriun e varfër shqiptar.

Po të gjykosh ngatë përditshmet, del se në atë periudhë hutimi kanë ndodhur transformime të hatashme që do t'i kishte zili dhe Magjistari i Mom sepse në Shqipërinë tonë të vogël qahet dhe po aq lehtë qeshet në të njëjtën kohë. Më shumë sesa cdo gjë tjetër, në sprovë ishte njeriu me të drejtat e tij. Muri do të binte por a do të binte në kokën e tij?

Kishin kaluar më shumë se 50 vite që prej ndarjes së madhe. Dhe trandi i gjendjes shpirtërore të popujve në vendet e Lindjes ishte po aq i madh. Më kot janë bërë kërkime për të saktësuar fillimin e kësaj mbrapshtie. Asnjë historian nuk ka rënë në një mendje për këtë. Mospajtimet shtohen vecanërisht nga që ata nuk kanë mundësi të shfrytëzojnë burime arkivore sepse pikërisht atëherë arkivat u mbyllën deri në një kohë të caktuar.

Sepse ishim vërtet mesa duket Në Kohën e Të Marrëve.

Në kohën e dalldivë, të cilat pavarësisht magjisë që reflektojnë një cast shuhen gjithmonë shumë shpejt. / gazetatema.net



'Turqit janë të gatshëm që të bëjnë film për Adem Jasharin'

Aktori i njohur kosovar, Vedat Bajrami ka thënë se regjisorët dhe aktorët e Turqisë janë të gatshëm dhe kanë potencial të realizojnë një film për komandantin legjendar, Adem Jashari.

Siç tregoi ai, këtë vit së bashku me ekipën dhe një regjisor turk kanë vizituar Kompleksin Memorial "Adem Jashari", me ç'rast janë informuar edhe fizikisht me historinë e komandantit.

"Unë e kam pas Kazimin dhe komplet ekipën me një regjisor shumë të madh turk në Prishtinë dhe në vizitë të Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Kanë marrë shumë informata, e kanë pa vendin edhe pse e dinë këta luftën në Kosovë, se kanë qenë pjesëmarrës vetë, edhe shteti turk na

ka ndihmu. Janë interesuar shumë më shumë rreth filmit. Është ëndërr e çdo produksioni me të filmin e Adem Jasharit. Unë mendoj që ka potencial me u bë filmi i tij", u shpreh ai në RTV21.

Ai tha se pavarësisht që Kosova ka depertuar nëpër festivale në botë, diçka e ngjashme si film të luftës nuk ka bërë, dhe për këtë arsye ai e sheh si të domosdoshme krijimin e një filmi të tillë për historinë tonë.

"Është një temë shumë sensitive, një temë e ndjeshme që duhet me u plasë shumë bukur. Për me e realizu duhet me e pas një qasje shumë ndryshe. Filmin nuk mundemi me bë pa ndihmën e njerëzve, pa një super buxhet dhe pa konsultime", u shpreh Vedati.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Istogu në raundin e tretë përballet me luventa Michalovce

ISTOG, 3 TETOR - KHF Istogu ka mësuar të martën kundërshtarin e raundit të tretë të Kupës Evropiane për Hendboll. Shorti i tërhequr në Vjenë ka përcaktuar që Istogu të përballet me skuadrën e njohur sllovaqe luventa Michalovce. Ndeshja e parë luhet në Sllovaki,

ndërsa e kthimit në Kosovë. Ndeshjet e raundit të tretë të Kupës Evropiane zhvillohen më 11/12 dhe 18/19 nëntor. Në raundin e dytë të Kupës Evropiane kampioni ynë e eliminoi skuadrën portugeze 1Maio/Ada. Luventa Michalovce ka në përbërje shumë lojtare të huaja dhe

lojtare cilësore sllovaqe. Është skuadër e nivelit të lartë, ndërsa edicionin e kaluar arriti deri në gjysmëfinale të Kupës Evropiane. Ka përvojë shumë të gjatë në gara evropiane, por istogaset kanë synimet e tyre, ndonëse nuk e kishin fatin në short.



Stadiumi 'Fadil Vokrri' mund të mos rinovohet fare

PRISHTINË, 3 TETOR - Stadiumi "Fadil Vokrri" mund të mos rinovohet fare dhe të ruhet si trashëgimi dhe traditë historike. Kjo për arsye të vjetërsisë së strukturave origjinale të tij, të cilat, sipas ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, mund të mos e durojnë edhe një tjetër ndërhyrje për renovim. Sipas tij, kjo çështje është duke u vlerësuar nga ekspertët e ndërtimit dhe më pas do të merret një vendim final. "Një vlerësim po i bëhet edhe 'Fadil Vokrri'. Janë dy mendime të profesionistëve në lidhje me 'Fadil Vokrri' dhe njëri nga këto mendime është që për shkak të vjetërsisë së strukturave origjinale, sepse ka kaluar një kohë shumë e gjatë prej kur është



ndërtuar ai stadium dhe për shkak të telasheve teknike që kanë pasur në renovimin e fundit kur është bërë renovimi për t'iu përshtatur kriterëve të UEFA-s, janë hasur shumë vështirësi të cilat mund ta

pamundësojnë një renovim të ri të këtij stadiumi. Pra, e kemi këtë mendim profesional të cilin ne nuk mund ta injorojmë si vendimmarrës politik dhe duhet ta validojmë këtë mendim dhe nëse qëndron kjo,

atëherë i bie që ne nuk guxojmë të prekim sepse mund të bëjmë dëm më shumë në ato struktura sesa të ofrojmë ndonjë zgjidhje", ka thënë Çeku për "KosovaPress". Ai ka thënë se stadiumi "Fadil Vokrri" duhet të ruhet edhe si trashëgimi dhe traditë me rëndësi, ndërsa potencoi nevojën që kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, të ketë një stadium krejtësisht të ri. "Por Prishtina, fillimisht me Bënicën si një stadium i ri, sado që të jetë stadium ndihmës dhe lokal, ofron edhe një hapësirë, por besoj që Prishtina e meriton edhe një stadium të ri i cili do të ndërtohet. E tani a do të jetë ky stadium nacional, apo do të jetë një stadium tjetër vetëm i qytetit të Prishtinës nuk e di, por ne

jemi shumë të interesuar që Prishtinën ta trajtojmë me prioritet. 'Fadil Vokrri' duhet ta ruajmë edhe si trashëgimi dhe si traditë dhe si e kaluar. Mbase ai do të mbetet kështu siç është dhe nëse konfirmohet mendimi profesional që strukturat e stadiumit 'Fadil Vokrri' nuk e përballojnë edhe një ndërhyrje renovuese, zgjidhja duhet të jetë një stadium i ri për qytetin e Prishtinës", ka theksuar Çeku. Duhet cekur se "Fadil Vokrri" është stadiumi i vetëm në Kosovë që plotëson kriteret e UEFA-s për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare. Në planin pesëvjeçar Çeku ka bërë me dije se do të ndërtohen dhe rinovohen 27 stadione të futbollit.

Dortmundi dhe Milani në kërkim të fitores së parë

DORTMUND, 3 TETOR (ER) - Borussia Dortmund dhe AC Milani në kërkim të fitores së tyre të parë në Grupin F të Ligës së Kampionëve përballet mes vete në "Signal Iduna Park" të mërkurën. Klubi gjerman pati paraqitje të mirë në ndeshjen e parë, por është mposhtur 2-0 nga Paris Saint-Germain, ndërsa kuqezinjët luajtën baras 0-0 me Newcastle Unitedin. Borussia Dortmundi në këtë ndeshje vjen pas fitores në fundjavë ndaj Hoffenheimit me rezultat 3-1, derisa fitore në derbin e Serisë A ka shënuar edhe



Milani kundër Lazio (2-0). Edhe ndeshja tjetër e këtij grupi mes Newcastle Unitedit dhe Paris Saint-Germainit do të jetë shumë interesante, pasi klubi anglez po

tregon rezultate të mira edhe në këtë edicion. Një tjetër ndeshje e fortë do të zhvillohet edhe në Gjermani, ku Leipzigu e pret kampionin në fuqi të garës më të



fortë në futboll, Manchester Cityn. Të dyja këto skuadra i kanë fituar ndeshjet e para me rezultat 3-1 ndaj Young Boysit dhe Crvena Zvezdas.

GRUPI E
18:45 Atletico Madrid - Feyenoord
21:00 Celtic - Lazio
GRUPI F
21:00 Borussia Dortmund - AC Milan
21:00 Newcastle United - Paris Saint-Germain
GRUPI G
21:00 FK Crvena Zvezda - Young Boys
21:00 RB Leipzig - Manchester City
GRUPI H
18:45 Royal Antwerp - Shakhtar Donetsk
21:00 FC Porto - Barcelona

Shtatë trajnerë të tenisit pajisen me certifikata

PEJË, 3 TETOR - Shtatë trajnerë të tenisit janë pajisur me certifikata të përfundimit me sukses të kursit për trajnerë (niveli i dytë), i organizuar nga KOK-u në bashkëpunim me Federatën e Tenisit të Kosovës, falë mbështetjes së Solidaritetit Olimpik të IOC. Kursi ishte mbajtur në fushat e tenisit

në Brestovik të Pejës, prej 30 qershorit deri më 11 korrik 2023, ndërsa ligjërues ishin Goran Shevchenko nga Maqedonia e Veriut dhe Kenan Malucbegoviq nga Bosnja e Hercegovina. Certifikatat u ndanë nga presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe kryetari i FTK-së, Jeton Hadërgjonaj, të cilët

i përgëzuan trajnerët për certifikimin, duke besuar se dijen e tyre të fituar nga ligjëruesit do ta ndajnë me tenisistët e rinj. Trajnerët të cilët morën certifikata të IOC janë: Benita Selmanaj, Blearta Ukëhaxhaj, Tamara Martinovska, Viola Peja, Festim Ibrahim, Vladimir Tomiq dhe Zahir Rama.



KB Trepça në Estoni do t'i zhvillojë ndeshjet e para në FIBA Europe Cup

ISTOGU, 3 TETOR - KB Trepça në Estoni sot (e mërkurë) e zhvillon ndeshjen e parë në FIBA Europe Cup ndaj skuadrës nga Islanda, Tindastoll. Një ditë më pas, Trepça përballlet me Parnu. Synimi i klubit kosovar është vendi i parë në grup dhe avancimi në fazën tjetër. "Jemi në Parnu të Estonisë, ku do t'i

zhvillojmë ndeshjet e para në FIBA Europe Cup, e që shpresojmë shumë se nuk do të jenë të fundit për këtë edicion. Skuadra është shumë e motivuar dhe e përkushtuar për të dhënë maksimumin për sukses në Evropë. Të mërkurën (4 tetor) luajmë me skuadrën nga Islanda, Tindastoll. Ndeshja

fillon në orën 18:00. Të enjten (5 tetor) luajmë me skuadrën vendase, Parnu. Edhe kjo ndeshje fillon në orën 18:00. Të dyja ndeshjet transmetohen në kanal zyrtar të FIBA-s në 'youtube'. Udhëtimi i gjatë për në Estoni është bërë pa asnjë problem, ndërsa atmosfera në skuadër është e shkëlqyer.

Synimi është i qartë: vendi i parë në grup dhe avancimi në fazën tjetër. Lojtari i gjashtë do të na mungojë (apo ndoshta edhe nuk do të na mungojë?), por e dimë që jemi në mendjet e zemrat e të gjithë juve në Mitrovicë. Ky është motivi ynë më i madh", thuhet në njoftimin e Trepçës.



Gripshi, 'Ylli i javës' në Superligën e futbollit



SUHAREKË, 3 TETOR - Mesfushori i FC Ballkanit, Nazmi Gripshi, e ka fituar çmimin "Ylli i javës" për xhiron e 8 të Albi Mall Superligës. Komisioni i veteranëve të futbollit në përbërje: Lulzim Berisha, Synaj Keçi, Emin Sekiraqa, vendosi që epitimi i më të mirit për këtë xhiro t'i takojë mesfushorit të skuadrës nga Suhareka, pasi në ndeshjen kundër

KF Llapit kishte paraqitje të shkëlqyeshme duke shënuar një eurogol dhe duke e udhëhequr ekipin drejt fitimit të tri pikëve të rëndësishme për ta marrë kreun e renditjes në Superligë. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e FC Ballkani e dha Blerina Tmava, specialist i rrjeteve sociale në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim, Gripshi

u shpreh i lumtur për vlerësimin. "Jam i lumtur për këtë vlerësim nga FFK-ja. Falë paraqitjeve të mira si nga ana personale ashtu edhe e bashkëlojtarëve në çdo ndeshje po arrijmë t'i marrim nga tri pikë. Shpresoj të vazhdojmë kështu duke e ruajtur vendin e parë", ka thënë Gripshi për faqen zyrtare të FFK-së.

Broja qetëson Sylvinhon: Dola nga fusha për shkak të lodhjes fizike

LONDËR, 3 TETOR - Ylli i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, e ka gjetur rrugën e golit në ndeshjen ndaj Fulhamit (2-0) në kuadër të Premier Ligës. Pas ndeshjes sulmuesi kuqezi foli për mediet britanike për emocionet e golit të shënuar e më pas qetësoi trajnerin e Kombëtares së Shqipërisë se dalja nga fusha më herët se çfarë pritej ishte për shkak të lodhjes. "Është një fitore që na jep një dozë të madhe besimi neve si skuadër, por edhe klubit. Ndryshuam shumë këtë verë, duke ndërtuar një skuadër të re, ndaj edhe është e nevojshme për pak kohë për ta njohur njëri-tjetrin. Është gjithmonë e vështirë kur ke futbollistë të rinj dhe staf të ri, por ne jemi duke treguar se tani ndihemi mirë dhe kjo fitore është një karikim me besim për të ardhmen. Goli? Është fantastike. Si



sulmues, unë dua të shënoj gjithmonë, në skena të mëdha dhe në momente të mëdha. Një ndjenjë e pabesueshme të shënosh gol në një derbi. Ishte fantastike t'i merrim tri pikët. Unë jam këtu për të luajtur për skuadrën, për t'i ndihmuar shokët dhe për të shënuar sa herë që të më jepet mundësia", ka thënë

Broja. "Fitoret sjellin besim dhe pozitivitet në grupin e futbollistëve në klub, por edhe në raport me tifozët. Është shumë e rëndësishme të fitosh dhe shpresoj të vazhdojmë në këtë rrugë. Lëndimi? Nuk ishte dëmtim, por lodhje dhe kërkova zëvendësim. Nuk i kam ende 90 minuta në këmbë", ka shtuar Broja.

SHKURT

KV Peja mëson rivalët në Kupën Ballkanike

Kampionia e Kosovës në Volejball, KV Peja, është nisur në drejtim të Bursas. Ajo do të jetë pjesë e BVA Kupës Ballkanike në volejball për meshkuj. Sipas shortit, KV Peja do të garojë në Grupin B së bashku me Bursa Buyuksehir dhe OK Universiteti Tetovë. Në Grupin A garojnë OK Bosna nga BeH, Pigassos Polichnis nga Greqia dhe Spartak nga Serbia. Ndeshjet e BVA Kupës Ballkanike do të zhvillohen në palestrën Cengiz Gollu në Bursa të Turqisë. Kjo garë zhvillohet nga 4 deri më 7 tetor 2023.

Rrahmani, lojtari i javës në Rumani

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Albion Rrahmani, vazhdon shkëlqimin në elitën e futbollit rumun me skuadrën e Rapid Bukureshtit. Rrahmani është zgjedhur lojtari më i mirë i javës në Rumani teksa ka qenë protagonist edhe në xhiron e 10 të kampionatit rumun ku i shënoi dy gola dhe e bëri një asistim në fitoren e Rapidit me rezultat 3-1 kundër Clujit. Ish-futbollisti i Malishevës dhe i Ballkanit njihet si "Lewandowski" i Kosovës. "Lewa e fitoi trofeun e parë të Superligës së Rumanisë si lojtari më i mirë i xhiros së 10", shkruan Rapidit në "Facebook", i cili e përcolli atë me një fotografi të përfaqësuesit kosovar me trofeun e fituar. 23-vjeçari i ka realizuar gjashtë gola në pesë ndeshje të zhvilluara në elitën e futbollit rumun që pas transferimit të Rapidit nga Ballkani.

Trajneri i Çekisë: Vështirë në 'Air Albania', por shkojmë për fitore

Trajneri i Kombëtares së Çekisë, Jaroslav Silhavy, gjatë konferencës për shtyp, ku shpalli listën e të ftuarve për ndeshjen me kuqezinjtë më 12 tetor, theksoi se i pret një ndeshje e vështirë në "Air Albania" por, sipas tij, ekipi do të luajë për gjithçka. "Besojmë se mund t'ia dalim. Është mirë që të gjithë lojtarët janë në formë. Nuk dua të bëj ndryshime menjëherë në çdo takim. Ne e dimë se çfarë na pret atje. Kemi disa informacione nga polakët që humbën 0-2. E pamë ambientin, shqiptarët kanë shumë temperament. Shkojmë atje për fitore. Ndeshja në Shqipëri ndoshta do të jetë shumë më e vështirë se ajo në shtëpi. E kemi bërë të vështirë, por besoj se mund t'ia arrijmë qëllimit kur bëhet fjalë për të luajtur për gjithçka", ka thënë Silhavy.

Sainz: Vetëm Ferrari mund ta mund Red Bullin

Piloti spanjoll Carlos Sainz kishte thënë më herët se nëse Red Bulli do të zhgënjente në ndonjë garë, makina që do ta fitonte atë ishte Ferrari. Dhe ashtu ndodhi. Në pistën e Singapores, "kokëkuqja" triumfoi pikërisht me Sainzin. Suksesin në këtë garë, i dyti në karrierë për spanjollin, e ka motivuar atë që kërkon podiumin në garën e radhës në Katar. "Jam gjithnjë optimist. Në dy sezonet e fundit makina e vetme që ka qenë në gjendje të duelojë me Red Bullin ka qenë Ferrari. Me rregullat e reja ajo makinë është thuajse e pamundur. Nëse ka ndonjë makinë që mund t'ia mund kampionët e botës jemi ne. Është Ferrari. Jam në një pozitë që e shoh veten kompetitiv. E dimë se çfarë na mungon. E identifikua problemin dhe po e zgjidhim për vitin tjetër. Tani na duhet kapaciteti i duhur për të reaguar", ka thënë Sainz. "Për mua është Red Bulli ajo që bën ende diferencën. Nëse ata nuk do të ishin, do të kishim një sezon si protagonist dhe do të ishte një nga sezonet më të duelura mes nesh, Aston Martin, Mercedes e McLaren", ka shtuar Sainz.

Ibra synon të bëhet trajner i Milanit

Zlatan Ibrahimoviçiqi nuk ka ndërmend të shkëputet nga Milani, por synimi i tij nuk është që të zbresë më në fushë. Presidenti Paolo Scaloni ka

menduar t'i ofrojë një rol të rëndësishëm, ndoshta edhe drejtimin e skuadrës në një të ardhme të afërt. Italianët janë të hapur për diskutime duke qenë

se 42 vjeçari nga Malmo tanimë konsiderohet legjendë e këtij klubi, ndër më të famshmit në futboll. Duhet kujtuar se Stefano Pioli do të jetë në krye të

bankinës së Milanit deri në 30 qershorin e 2025-s, një vit ku mund të jetë shansi i duhur për debutimin e suedezit si trajner. Ibrahimoviçiqi asnjëherë nuk e

ka fshehur dëshirën për t'u bërë trajner, pasi edhe kur ishte i lënduar te Milani, shpeshherë ishte shumë aktiv nga bankina për t'i motivuar shokët.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumescdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leonora Ferizi shpall të pavlefshme Licencën e punës të shkollës së mesme "Dr. Xheladin Deda".

- "Lille Creativ" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 810010489.

- Fisnik Thaqi shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Kushtrim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Leke Dugagjini" Prizren.

- Lulzim Hoti shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Anisa Vila shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Dardania" Hani i Elezit.

- Artan Vehapi shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Festim Qafleshi shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Kushtrim Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Arben Dula shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

- Beis Islami shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme Medresea "Alaudin" Prishtinë.

- Isuf Gashi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe Diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

